



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. Prot 3598

Elbasan më 16 /07/2025

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin QERSHOR 2025
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin QERSHOR 2025 ,
241 familje me një fond prej 1.168.635 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Miratoi: D.Rroseni

ZV/KRYETARI

ARMAND SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/07/2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/07/2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin QERSHOR 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/07/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin QERSHOR 2025 për 241 familje me një fond prej **1.168.635** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE
DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
QERSHOR 2025

I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025

Qershor	241 familje	fondi	1.168.635
Maj	257 familje	fondi	1.221.389

Për muajin Qershor 2025 kemi 16 familje më pak se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 52.754 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Sami Idrizi (aplikon ne sistem)
2. Agim Muça (ka dale ne pension)
3. Roven Shkëmbi (emigracion)
4. Esterina Lazi (aplikon ne sistem)
5. Haki Duka (aplikon ne sistem)
6. Serjan Çekrezi (aplikon ne sistem)
7. Renco Xhelili (aplikon ne sisem)
8. Arben Koçi (ka dale me P.A.K)
9. Emanuel koçiasi (ka dale ne pension)
10. Suela Vogli (ka filluar pune)
11. Luljeta Mançka (aplikon ne sistem)

II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Qershor 2025

Qershor	79 familje	fondi	235.000
Maj	75 familje	fondi	214.440

Për muajin Maj 2025 kemi 4 familje më pak se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 20.560 lekë më shumë se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

- | | |
|------------------|---------------------|
| 1. Bujar Jolla | (aplikon ne sistem) |
| 2. Taulant Bitri | (aplikon ne sistem) |
| 3. Arben Bahja | (aplikon ne sistem) |
| 4. Ilir Çela | (aplikon ne sistem) |
| 5. Artan Quku | (aplikon ne sistem) |
| 6. Nikoll Dedja | (aplikon ne sistem) |
| 7. Besnik Paja | (nuk paraqitet) |
| 8. Ramazan Hamza | (nuk paraqitet) |
| 9. Sabri Qoshku | (nuk paraqitet) |
| 10. Gëzim Balla | (nuk paraqitet) |

Konceptoi

Specialiste Ermira Dika

Pergjegjese Sektori

Miranda Duka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 3599 Prot

Elbasan më 16 /07/2025

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2025

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin QERSHOR 2025 gjithsej 79 familje me një fond gjithsej 235.000 lekë.
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit.
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.


Konceptoi: M.Duka

Pranoi: D.Shuli

Konfirmoi: D.Rroseni

Zv/Kryetari

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/07/ 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/07/ 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/07/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin QERSHOR 2025 për 79 familje me një fond prej 235.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale
Drejtori Juridik

D.Shuli
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

Nr. 3660 Prot.

Elbasan, më 21/07/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Lënda: Relacion për Planin Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2030

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një sërë hapash për përparimin drejt barazisë gjinore. Në këtë aspekt tre (3) Planet Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2018-2020, 2022 – 2024 dhe së fundmi 2025-2030 janë përgatitur nga bashkia, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore. Bashkia Elbasan e ka nënshkruar këtë Kartë, të përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës në 23 shkurt 2017 duke ndërmarrë kështu një angazhim publik për të hedhur hapa konkretë dhe të duhur për bërjen realitet të barazisë gjinore në Elbasan.

PVVBGJ 2025-2030 është plani i tretë i veprimit që hartohet për këtë qëllim, përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, median, bizneset, Forumin e Qeverisjes së Hapur (OGP), Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e antarë të Këshillit Bashkiak, proces i cili u mbështet nga UN Women Shqipëri.

Paralelisht me zhvillimin e procesit të hartimit të PVVBGJ 2025-2030 bashkia Elbasan ka realizuar dhe Raportin e Monitorimit të Zbatimit të PVVBGJ 2022-2024. Nga analiza e zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024 rezulton se Bashkia ka demonstruar progres në të katër fushat ndërhyrëse të planifikuara në këtë PVVBGJ.

Ndër arritjet kryesore përmendim:

- Pjesëmarrjen e rregullt të Nëpunësës së Barazisë Gjimore në mbi 30 takime të buxhetimit me pjesëmarrje, të zhvilluara për periudhën 2022 – 2024 në kuadër të përgatitjes së buxhetit, ku në fokus të punës së saj është procesi i angazhimit të qytetareve/qytetarëve veçanërisht grave/të rejave duke bashkepunuar me Administratoret/Administratorët e Njërive Administrative.

Rikonstruksionin e 18 objekteve shkolla, kopshte, çerdhe nga të cilat 10 në zonat urbane dhe 8 në zonat rurale, për vitin 2024. Rikonstruksionin e pjesshëm të 51 objekteve arsimore, nga të cilat 29 në zonat urbane dhe 22 në zonat rurale, për vitin 2024.

- Pjisjen e shkollave, kopshteve, çerdheve me kamera për të rritur nivelin e sigurisë së fëmijëve vajza e djem. Gjithashtu bashkia financon çdo vit pagesën e kopësht/çerdhe për 35 raste të fëmijëve të familjeve në nevojë, kryesisht Rom/Egjiptjan, si dhe të rasteve të fëmijëve të përfshirë në UM/UMM. Kanë përfituar gjithsej 105 fëmijë në nevojë për periudhën 2022-2024.
- Menaxhimin me efektivitet dhe mbështetjen me shërbime bazuar në nevojat përkatëse për vitet 2022 - 2024 të 381 rasteve të reja të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Mbështetjen në vazhdimësi të shërbimit të strehimit emergjent, na bashkëpunim me OJF të specializuara që e ofrojnë këtë shërbim, duke mbuluar qeranë e strehëzës.
- Aplikimin e 4 programeve të prindërimit pozitiv në 4 Qendra Komunitare respektivisht Qendra komunitare Rome, Qendra Komunitare Shushicë, Qendra Komunitare ADRA dhe Qendra komunitare "Një tjetër Jetë", në bashkëpunim me fondacionin A2B.
- Në kuadër të projektit Rrugëtimi i të rinjve drejt mirëqënies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë me mbështetjen e Save the Children, janë zhvilluar 30 sesione të këshillimit për karrierën, mbi rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve qoftë dhe atyre jo tradicionale.
- Është ngritur një shërbim që mundëson kujdesin për fëmijët pasdite deri në orën 18.00, për nënat e vetme që punojnë si edhe për ato në vështirësi ekonomike. Ky shërbim mundësohet nga fondacioni motrat e Nënë Terezës me seli në Elbasan.
- Është ngritur një treg i vogël i zejeve ku gra/vajza ekzpozojnë dhe shesin punime të ndryshme të realizuara me dorë në mënyrë tradicionale si qilima, veshje popullore, bizhuteri etj. Këto sipërmarrje të vogla janë lehtësuar nga taksat e bashkisë dhe bashkia u ka vënë në dispozicion një hapësirë publike.
- Një arritje veçanërisht e rëndësishme gjatë vitit 2024, e pa planifikuar në dokumentin e PVVBGJ, por që ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e masave të parashikuara në objektivin specifik IV.2. "Fuqizimi dhe rritja e efektivitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore", të këtij plani, ishte ushtrimi i kostimit të shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore (DHF/DHBGJ), i zhvilluar me mbështetjen teknike të UN Women. Ky ushtrim ndihmoi bashkinë të kuptojë më mirë kostot reale të parandalimit, mbrojtjes dhe referimit të

rasteve, duke pasur parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që ligjërisht mbulon bashkia, si dhe kontribuoi në një planifikim më të informuar të buxhetit të vitit 2025, por edhe të PBA 2025 – 2027, për këto ndërhyrje jetike.

Praktikat e mira përfshijnë bashkëpunimin aktiv të bashkisë me shoqërinë civile në fushatat ndërgjegjëse, përdorimin e platformave në shkolla për edukimin mbi barazinë gjinore si dhe përpjekjet për të integruar çështjet gjinore në planifikimin dhe buxhetimin vendor.

Pavarësisht aritjeve, bashkia në këto vite ka ndeshur edhe vështirësi dhe sfida dhe ka edhe aktivitete të pa realizuara tërësisht ose pjesërisht. Këto janë evidentuar të detajuara në raportin përkatës të monitorimit të zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024 .

Bazuar në sa më sipër Bashkia ka në vijim si prioritete:

- Hartimin, miratimin dhe zbatimin e PVVBGJ 2025 – 2030, bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet nga raporti i monitorimit;
- Institucionalizimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në të gjitha programet buxhetore dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në iniciativat për barazinë gjinore;
- Forcimin e mëtejshëm të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje dhe përmirësimin e sistemeve të të dhënave dhe transparencës.
- Përmirësimin e kapaciteteve të stafit për adresimin në mënyrë më efektive të çështjeve të barazisë gjinore në të gjitha fushat e ndërhyrjes së bashkisë, si dhe vënienë në dispozicion të burimeve të shtuara financiare, për të siguruar që barazia gjinore të integrohet në mënyrë sistematike në të gjitha politikat dhe shërbimet e bashkisë.

PVVBGJ 2025-2030 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me planin e mëparshëm të veprimit për barazinë gjinore, përfshirë vështirësitë apo sfidat e ndeshura për zbatimin e tij, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Në PVVBGJ 2025-2030 është parashikuar vlerësimi i ndikimit gjinor të ndërhyrjeve, si dhe përgatitja e mëtejshme e dokumentave të tillë duke përdorur lente gjinore gjë që synon pikërisht përgatitjen e bashkisë për të avancuar në planifikim, zbatim, monitorim e vlerësim të të gjitha ndërhyrjeve të saj, nën këndvështrimin gjinor, duke mundësuar gjithashtu një dokumentim sa më të mirë të rezultateve të matura me tregues të mirëpërcaktuar e të ndjeshëm gjinorë. Kjo do të ndihmojë njëkohësisht edhe në mbajtjen e të dhënave të përditësuara e të ndara jo vetëm në bazë të seksit, por edhe të moshës, vendbanimit, etnisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, statusit të migrantës / migrantit apo azilkërkueses / azilkërkuesit, probleme të ndryshme sociale që mund të përjetojnë, etj.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030 u përgatit me një metodologji gjithëpërfshirëse, duke filluar nga: analiza dhe përshkrimi i situatës, përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, konsultimet paraprake brenda bashkisë, përgatitja e draft dokumentit, si dhe konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit, në përfundim të të cilave u realizua edhe kostimi i dokumentit, për ta përcjellë më pas për miratim në Këshillin Bashkiak.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjithë anëtareve dhe antarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja **“nga të gjithë grupet”** që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë që lidhet me përkatësinë e shumëfishtë (intersectionality ndërlidhja e kategorizimeve shoqërore si raca, klasa dhe gjinia, që mbivendosen tek një individ ose grup i caktuar, e konsideruar si krijim i sistemeve të ndërvarura të diskriminimit ose disavantazhit.) dhe diversitetin si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, migrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBGJ 2025 – 2030, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentat kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) Instrumente ndërkombëtarë

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality)
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA)
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)
- Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ)
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar



Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

- Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligjin 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar
- Ligji nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Plani PVVBGJ(2025-2030) ndryshe nga PVVBGJ 2022-2024 përbëhet nga pesë fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por kanë të reflektuar dhe 9 nenet e reja të të Kartës Evropiane për Barazi dhe janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumfishtë.
- III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.
- IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe efikasitetit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.
- V. Të tjera (referuar 9 neneve të Kartës Evropiane për Barazi)

Plani ka gjithashtu, synimin të shërbejë si bazë për dialog të mëtejshëm me Qeverinë Shqiptare, Donatorë (ndërkombëtarë dhe kombëtarë) dhe partnerët socialë / shoqërinë civile mbi çështjet e barazisë gjinore.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e këtij plani janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentat kryesore ku mbështeten hapat e planifikuara.

Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe OJF të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe Aleanca e Grave Këshilltare, Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel të Këshillit Bashkiak, Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga përfaqësues dhe përfaqësues të Drejtorive kryesore përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ 2025-2030, anëtarët e Forumit të Qeverisjes së Hapur (OGP), të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi:N/Gjinore Ervola Omeri

Miratoi : Pergj. Nadire Kreka

Pranoi: Dr.DMPS Eltiona Kolla

KRYETARI
Gledian Llatja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ prot

Elbasan me ____ . ____ . 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë ____ / ____ / 2025

**Mbi miratimin në parim të dokumentit strategjik: “Plani Vendor i
Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030 ”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ / 2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në mbështetje të nenit 28/1 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” Ligji Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë” Ligji nr 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” Ligji Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar” Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar Ligji 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar

VENDOSI

1. Të miratojë në parim “Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore « 2025-2030 »
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi grupi i punës i ngritur me Urdhër Administrativ Nr.429 datë 18/06/2025 dhe Agjencia e Shërbimeve Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori DMPS E.Kolla

Drejtori Buxhet-Financë A.Merkja

Drejtori Juridik A.Hoxha

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Lutfi LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 3713 Prot.

Elbasan, më 23/07/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Lënda: Relacion për Raportin e Monitorimit të Planit Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore 2022-2024

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një sërë hapash për përparimin drejt barazisë gjinore. Në këtë aspekt tre (3) Planet Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2018-2020, 2022 – 2024 dhe së fundmi 2025-2030 janë përgatitur nga bashkia, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Paralelisht me zhvillimin e procesit të hartimit të PVVBGJ 2025-2030 bashkia Elbasan ka realizuar dhe Raportin e Monitorimit të Zbatimit të PVVBGJ 2022-2024.

PVVBGJ 2022-2024 i Bashkisë Elbasan si një instrument strategjik, është i zhvilluar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030. Ai gjithashtu është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBGJ 2022 – 2024 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm
- IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe efikasitetit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

V.

Nga analiza e zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024 rezulton se Bashkia ka demonstruar progres në të katër fushat ndërhyrëse të planifikuara në këtë PVVBGJ.

Fusha I: Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.

Objektivi I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

Bashkia ka treguar vendosmëri për të avancuar barazinë gjinore në nivel vendor, përmes përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ). Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, transparent dhe në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm institucionalë dhe të shoqërisë civile. Menjëherë pas hartimit, dokumenti u publikua në faqen zyrtare të bashkisë për konsultim publik, duke garantuar transparencë dhe përfshirje të komunitetit lokal dhe grupeve të interesit. Pas fazës së konsultimit, drafti u miratua nga Këshilli Bashkiak. Më pas, dokumenti u përkthye nga UN Women në gjuhën angleze dhe u përshtat në një version të përshtatshëm për publikim në ëeb. PVVBGJ i miratuar u publikua në faqen e internetit të bashkisë (eëë.elbasani.gov.al)

Veprimet e ndërmarra më pas dëshmojnë një angazhim serioz dhe të qëndrueshëm të bashkisë për të promovuar barazinë gjinore, përmes një qasjeje të strukturuar, të hapur dhe bashkëpunuese.

Në kuadër të procesit të Buxhetimit Gjinor me Pjesëmarrje bashkia ka ngritur një database mbi pjesëmarrjen e grave/të rejave/vajzave si dhe burrave/të rinjve/djemve në çdo dëgjese komunitare që ka realizuar.

Objektivi I.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

Gjatë periudhës së zbatimit të PVVBGJ janë realizuar një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve në fushën e zbatimit të detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Janë zhvilluar trajnime për Komisionin për Barazi Gjinore dhe për stafin e bashkisë me pjesëmarrjen e 12 personave, mbi zbatimin e BPGJ dhe analizën gjinore në buxhetim. Ky aktivitet ka përmirësuar kapacitetet e anëtarëve të KBGJ dhe sektorit përkatës për të kuptuar dhe zbatuar analizën gjinore dhe Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ).

Buxhetimi me Pjesëmarrje është një proces që bashkia Elbasan e zbaton tashmë prej vitesh. Ky është një proces në të cilin banoret dhe banorët e bashkisë Elbasan, përfshirë Njësi Administrative e fshtarat, marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimmarrjen për shpërndarjen e burimeve financiare publike. Ky proces nuk është vetëm konsultativ, por një proces i drejtpërdrejtë dhe diskutim demokratik për vendimmarrjen e pushtetit vendor. Nëpunësja e Barazisë Gjinore ka marrë pjesë në të gjitha takimet e buxhetimit me pjesëmarrje që organizohen në kuadër të përgatitjes së buxhetit, apo ndërhyrjeve të ndryshme për zhvillim në komunitet. Prioritetet e dala nga ky proces apo dëgjesa të tjera komunitare listohen në bazë të votave që kanë marrë si nevoja të komunitetit dhe planifikohen për zbatim duke u përfshirë në hartimin e buxhetit afatmesëm të bashkisë, kjo në varësi dhe të mundësive financiare të bashkisë

Buxheti me Pjesëmarrje është vlerësuar si praktika më e mirë e bashkisë së Elbasanit, për sa i përket përfshirjes së qytetarëve specifikisht të grave dhe vajzave si dhe grupeve të marginalizuara sic janë komunitetet Rome, Egjiptjane në vendimmarrje. (eëë.elbasni.gov.al) Gjatë kësaj periudhe referuese janë hartuar Plani Vendor i Rinisë Elbasan 2023-2026, Plani Social i Bashkisë Elbasan 2023-2026 dhe Plani i Strehimit, të cilat reflektojnë një gjuhë të ndjeshme gjinore, gjë që do të përmirësohet ndjeshëm më tej.

Në përgjithësi, progresi është i konsiderueshëm, megjithatë disa aktivitete kërkojnë ndjekje dhe angazhim të mëtejshëm për të përmbushur plotësisht objektivat dhe tejkaluar sfidat që lidhen me kapacitetet e kufizuara teknike për realizimin e analizave të plota gjinore. Lind e nevojshme:

- Fuqizimi i kapaciteteve të stafit për analizën gjinore dhe BPGJ.
- Përmirësimi i sistemit të grumbullimit dhe analizimit të të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore.
- Thellimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësura.

Fusha II: Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.

Objektivi II.1: Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.

Rreth 4,500 qytetare dhe qytetarë morën pjesë në aktivitete ndërgjegjësuëse dhe edukative që trajtojnë stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe format e shumëfishta të diskriminimit, një arritje pak më poshtë objektivit të planifikuar prej 5,000 pjesëmarrësesh/pjesëmarrësish, duke vijuar angazhimin e fortë të viteve të mëparshme.

Për sa më sipër gjatë periudhës 2022 - 2024, Bashkia Elbasan, në bashkëpunim me organizata partnere dhe institucione të ndryshme, ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme me qëllim ndërgjegjësimin, fuqizimin dhe përfshirjen aktive të grave, vajzave, të rejave/rinjve dhe aktorëve institucionalë për reduktimin e stereotipeve gjinore, diskriminimit dhe përjashtimeve të shumfishta. Këto aktivitete janë realizuar në përputhje me objektivat dhe janë përqendruar në promovimin e modeleve pozitive të grave/vajzave, rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet mbi stereotipet gjinore, dhunën me bazë gjinore, etj.

Sa i përket parashikimeve lidhur me organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike që promovojnë fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave dhe sfidojnë stereotipet gjinore, Bashkia Elbasan ka organizuar çdo vit aktivitete kulturore në zonat rurale të titulluara Festa e Qershive - Njësia Administrative Godolesh, Miqtë e Malit në Njësinë Administrative Gjinar, Festa e Byshekut - Njësia Administrative Shushicë, "Funar Fest" Njësia Administrative Funar, Festa e Treganit - Njësia Administrative Tregan, për të kulmuar me Panairin e Ditës së Verës. Në këto aktivitete gratë, të reja dhe vajzat marrin pjesë në panairot ushqimore me gatime tradicionale të zonës së tyre, zeje, produkte artizanale, prodhime të bizneseve familjare dhe individuale duke u promovuar si forca kryesore në bujqësi, blektori, agro-turizëm dhe duke sfiduar stereotipet gjinore. Këto aktivitete kanë shërbyer jo vetëm për promovimin e grave/vajzave por dhe krijimin e ideve të bizneseve të drejtuara nga gratë/vajzat apo në formë shoqate siç është shoqata e grave "Agro Shirgjan" (ëëë: eëë.elbasani.gov.al)

Aleanca e Grave në Këshillin Bashkiak Elbasan është ngritur që në vitin 2018 dhe përbëhet aktualisht nga 25 gra/vajza. Gjatë periudhës së monitorimit janë zhvilluar gjithsej 6 trajnime me pjesëmarrjen e anëtareve të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Komisionit të Barazisë Gjinore pranë Këshillit Bashkiak Elbasan

Bashkia Elbasan koordinon çdo vit Fushatën e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Në periudhën raportuese janë realizuar 3 fushata në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe ato në nivel kombëtar me aktivitete të shumta të shoqëruara me materiale informimi dhe ndërgjegjësimi. Bashkia Elbasan cdo vit para fillimit të fushatës mbledh tryezën teknike për barazinë gjinore, duke ftuar aktorët lokalë me të cilët hartohet dhe kalendari i aktiviteteve për Fushatën e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Në këtë kalendar përcaktohen aktivitetet, aktorët përgjegjës dhe afatet kohore në përputhje me fushatat globale dhe kombëtare për eliminimin e dhunës me bazë gjinore.

Fushatat janë shoqëruar me një sërë **aktivitetesh ndërgjegjëse dhe edukative**, përfshirë:

- tryeza diskutimi me gra të suksesshme dhe profesioniste të fushës së shërbimeve publike;
- aktivitete sensibilizuese me të rinj/të reja në shkolla dhe universitete;
- ekspozita, shpërndarje materiali dhe postime në rrjete sociale me mesazhe që promovojnë barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës.

Janë përgatitur dhe shpërndarë **materiale informuese dhe ndërgjegjëse**

Objektivi II.2: Investimi në prindërimin pozitiv.

Në kuadër të zbatimit të Planit Vendor për Barazi Gjinore, objektivi II.2 synon forcimin e prindërimit pozitiv dhe fuqizimin e rolit të familjes në ndërtimin e një shoqërie më të barabartë dhe të ndjeshme gjinore. Qëllimi kryesor i këtyre ndërhyrjeve është promovimi i një kulture të prindërimit të përgjegjshëm, të bazuar në parime të barazisë gjinore, mirëqenies familjare dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Këto ndërhyrje në zbatim dhe të aktiviteteve të PVVBGJ janë realizuar në formën e një procesi për të arritur tek pika finale, zbatimi i programeve të prindërimit pozitiv pranë qendrave komunitare.

Më pas u zbatuan nga vetë bashkia **kurset e prindërimit pozitiv** në katër qendra komunitare, përmes të cilave janë përfshirë familje të ndryshme, duke u ofruar atyre njohuri dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie më të shëndetshme me fëmijët dhe partnerët. *Në këto kurse morën pjesë 80 prindër, pak më poshtë objektivit prej 95 prindërish për vitin 2024. Kjo tregon një pjesëmarrje të mirë, por kërkon ende përpjekje për të zgjeruar shtrirjen.*

Aktivitetet e realizuara kanë kontribuar në:

- Rritjen e kapaciteteve të stafit komunitar dhe institucional për të adresuar çështje të prindërimit dhe barazisë gjinore;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe prindërve mbi rëndësinë e prindërimit pozitiv;
- Krijimin e sinergjive ndërmjet shkollave, qendrave komunitare dhe organizatave joqeveritare për të mbështetur familjet;

- Hedhjen e hapave për institucionalizimin e këshillimit paramartesor në nivel vendor.

Zbatimi i plotë i të gjithë aktiviteteve të këtij objekti do të përforcojë më tej angazhimin e Bashkisë Elbasan për të ndërtuar një shoqëri ku familjet funksionojnë mbi baza të barazisë, respektit dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor

22.000 individë janë informuar mbi parandalimin e stereotipeve gjinore në punësim dhe promovimin e ekuilibrit midis jetës personale dhe profesionale, një arritje mbresëlënëse në krahasim me objektivin e planifikuar prej 18,000 për vitin 2024. Për të arritur në këtë rezultat është punuar në disa drejtime bazuar dhe në aktivitetet e PVVBGJ me qëllim përfshirjen e grupeve të interesit dhe atyre të cënueshme.

Takimet informuese me punëdhënësit dhe punëkërkeset/punëkërkesit kanë qenë të shumta dhe të fokusuara në promovimin e programeve të nxitjes së punësimit për grupet në nevojë, duke përfshirë të rejtat/rinjat me ide inovative. Këto takime janë mbajtur në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit duke ndihmuar në adresimin e barrierave në hyrjen në tregun e punës (fq. zyrtare AKPA, Forumi i Gruas, Tjetër Vizion).

Nëpunësja e Barazisë Gjinore dhe Koordinatorja Vendore kanë qenë organizatore të takimeve me vajzat dhe gratë e bizneseve private kryesisht fasonerive për t'i informuar ato mbi stereotipet gjinore në punësim, të drejtën e marrjes së lejeve të paguara edhe nga baballarët si dhe funksionimin e MKR ndaj dhunës në familje dhe me bazë gjinore.

Në arritjen e këtij objekti specifik është synuar dhe promovimi mediatic duke publikuar informacione të ndryshme në mediat sociale për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim. Janë realizuar disa POSTCAD të grave/vajzave mbi stereotipet gjinore me mbështetjen e shoqatës Forumi i Gruas.

Aktivitetet e zhvilluara kanë ndihmuar në:

- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve jo tradicionale dhe pjesëmarrjes së vajzave në STEM;
- Forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional në promovimin e punësimit për grupet në nevojë dhe të rejtat/rinjat me potencial inovativ;
- Nxitjen e diskutimeve për ndarjen e barabartë të punës dhe kujdesit në familje si pjesë e një kulture të barazisë gjinore.

Objekti III.2: Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.

Përqindja e grave dhe vajzave të mbështetura në sipërmarrje arriti në 0.03%, shumë më poshtë objekti të planifikuar prej 1%. Kjo tregon nevojën për investime më të fuqishme dhe masa të synuara për fuqizimin ekonomik të grave.

Aktivitetet e parashikuara në Planin Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore në Bashkinë Elbasan fokusohen në nxitjen e barazisë ekonomike përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë të grave dhe vajzave, duke u ofruar atyre shërbime konkrete për kujdesin ndaj fëmijëve, mbështetje për sipërmarrje, qasje dhe aftësi për tregun e punës.

Shërbimi “Shtëpia e Gjyshes” është një ndër nismat më të rëndësishme, i cili ofron kujdes pasdite për fëmijët e nënave të vetme që punojnë, por edhe për familje në vështirësi ekonomike.

Ky shërbim funksionon deri në orën 18:00 dhe realizohet në bashkëpunim me fondacionin "Motrat e Nënë Terezës" në qytetin e Elbasanit. Kjo ndërhyrje ka lehtësuar ndjeshëm barrën e kujdesit ndaj fëmijëve për gratë që janë të vetme dhe punojnë.

Megjithatë hartëzimi i iniciativave ekonomike të iniciuara, zhvilluara apo trashëguara nga gratë në Bashkinë Elbasan dhe mbështetja për brandimin e produkteve dhe përgatitjen e historikut të trashëgimisë janë aktivitete në proces, duke mbetur një fushë për ndërhyrje të mëtejshme.

Zonat rurale në bashkinë Elbasan kanë një traditë shumë të mirë në kultivimin e fruta/perimeve bio dhe ato që angazhohen më shumë në këtë proces janë gratë dhe vajzat duke ndihmuar ekonominë familjare. Kjo iniciativë e grave/vajzave është mbështetur nga bashkia duke bashkëpunuar me shoqërinë civile. Një shëmbull i tillë është **mbështetja për gratë në zinxhirin e vlerës së bujqësisë**, veçanërisht në NJA Labinot-Mal, me trajnime dhe pajisje për 25-30 gra, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe të të ardhurave përmes kultivimit të perimeve, me suportin e UN ËOMEN.

Një komponent kyç i këtij objekti është edhe **dalja e grave nga skema e ndihmës ekonomike**, përmes promovimit të alternativave të punësimit

Në fushën e të drejtave pronësore, janë organizuar **takime ndërgjegjëse me gra/vajza, burra/djem në komunitete urbane dhe rurale**, përfshirë edhe komunitetet rome dhe egjiptiane, ku është trajtuar veçanërisht e drejta e grave mbi tokën bujqësore, pra janë trajtuar tematika mbi të drejtat mbi pronësinë dhe mënyrën se si mund të gëzohen këto të drejta. Në vitin 2022 janë shpërndarë **345 certifikata pronësie**, nga të cilat **55 për gra**, një hap drejt balancimit gjinor në pronësi.

Fusha IV: Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Objekti IV.1: Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 "Gruaja, Paqja, Siguria".

Janë kryer 14 auditime të sigurisë nga stafi bashkiak në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Sigurisë, duke dyfishuar objektivin vjetor prej 6 auditimesh dhe duke treguar një përpjekje të fortë institucionale për të krijuar një mjedis më të sigurt për gratë dhe të rinjtë.

Rikonstruksionin e 18 objekteve shkolla, kopshte, çerdhe nga të cilat 10 në zonat urbane dhe 8 në zonat rurale, për vitin 2024. Rikonstruksionin e pjesshëm të 51 objekteve arsimore, nga të cilat 29 në zonat urbane dhe 22 në zonat rurale, për vitin 2024.

- Pjesisjen e shkollave, kopshteve, çerdheve me kamera për të rritur nivelin e sigurisë së fëmijëve vajza e djem. Gjithashtu bashkia financon çdo vit pagesën e kopësht/çerdhe për 35 raste të fëmijëve të familjeve në nevojë, kryesisht Rom/Egjiptjan, si dhe të

rasteve të fëmijëve të përfshirë në UM/UMM. Kanë përfituar gjithsej 105 fëmijë në nevojë për periudhën 2022-2024.

- Menaxhimin me efektivitet dhe mbështetjen me shërbime bazuar në nevojat përkatëse për vitet 2022 - 2024 të 381 rasteve të reja të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Mbështetjen në vazhdimësi të shërbimit të strehimit emergjent, na bashkëpunim me OJF të specializuara që e ofrojnë këtë shërbim, duke mbuluar qeranë e strehëzës.
- **Diskutimet në komunitet mbi sigurinë në hapësirat publike kanë mbledhur** grupe të ndryshme (gra, vajza, burra, të rinj), ku është diskutuar ndjesia e sigurisë dhe janë identifikuar problematikat në lagje dhe hapësira publike. Takimet kanë ndihmuar në evidentimin e nevojave prioritare për ndërhyrje infrastrukturore dhe institucionale.
- **Këshilli Vendor i Sigurisë Publike është një tjetër mekanizëm që është përfshirë në trajtimin e problematikave të evidentuara nga takimet komunitar** Bazuar në gjetjet nga takimet me komunitetin, janë zhvilluar 2 takime të dedikuara me MKR, ETN dhe KVSP për të analizuar rastet e dhunës në hapësirat publike dhe private, si dhe për të koordinuar veprimet institucionale

Paralelisht me aktivitetet për rritjen e sigurisë publike janë zhvilluar dhe takimet për promovimin e Rezolutës 1325

Janë organizuar takime dhe leksione të hapura në NJA, gjimnaze dhe fakultete për promovimin e Rezolutës 1325 dhe takime të hapura lidhur me zbatimin e Konventës së Stambollit, për të ndarë përvoja dhe mendime mbi sfidat dhe mundësitë për zbatimin sa më të mirë të tyre. Diskutime dhe shkëmbime mendimesh janë bërë gjithashtu nga të reja/rinj të shkollave të mesme, përfaqësueseve/ përfaqësuesve të institucioneve si Policia, Bashkia, OJF, Universiteti, etj. Janë zhvilluar gjithashtu takime me komunitetin fetar në Elbasan, me fokus adresimin e dhunës në familje dhe me bazë gjinore dhe ndarjen e roleve gjinore në shoqëri.

Një tjetër aktivitet për garantimin e sigurisë janë takimet informuese mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm,

Janë realizuar 30 takime ndërgjegjëse me nxënëse/nxënës mbi rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Trajnim i përbashkët i MKR, GTN dhe KVSP

Janë organizuar një sërë aktivitetesh për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve lokalë në trajtimin e dhunës në hapësirat publike e private. Ndër to përfshihen:

- Konferenca kombëtare mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (janar 2024)
- Takime me administratën, Këshillin Bashkiak dhe organizatat e shoqërisë civile

Ërkoshop me OSBE mbi rreziqet e armëve të lehta dhe mbështetjen e fushatave kombëtare

Objektivi IV.2: Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Qëllimi i këtij objektivi ishte rritja e kapaciteteve institucionale dhe komunitare për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe ofrimi i mbështetjes konkrete për viktimat, përmes një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme në nivel lokal.

Gjatë periudhës 2022 - 2024, Bashkia Elbasan ka realizuar një sërë aktiviteteve konkrete:

- **Trajnimi i 31 punonjëseve/punonjësve të NJVNRR-ve** për referimin e rasteve të dhunës dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre në mënyrë të vazhdueshme.
- **Fuqizimi i Koordinatorëve Vendore kundër Dhunës në Familje (KVDHF)**, përmes trajnimeve dhe mentorimeve të vazhdueshme, dhe përfshirjes në rrjete kombëtare bashkëpunimi.
- **Organizimi i 36 mbledhjeve të ETN** për diskutimin e rasteve konkrete, dhe **6 mbledhje të Komitetit Drejtues** për adresimin e sfidave strukturore.
- **Menaxhimi dhe mbështetja e 208 rasteve të dhunës në familje**, prej të cilave 157 raste të reja gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me MKR-në.
- **Përditësimi i sistemit REVALB** për regjistrimin e të dhënave, pavarësisht kufizimeve teknike.
- **15 trajnime për edukatore të çerdheve dhe kopshteve** mbi stereotipet gjinore dhe identifikimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve.
- **Mbështetje për funksionimin e strehëzës së emergjencës**, përmes pagesës së qirasë nga bashkia.
- **Strehim afatgjatë për viktimat**, me 63 gra/vajza të përfshira në programin e bonusit të qirasë gjatë tre viteve.
- **Shërbim falas i çerdheve/kopshteve** për 13 fëmijë të nënave me urdhër mbrojtjeje.
- **Ngritja e strukturës së monitorimit** të shërbimeve sociale dhe monitorimi i 9 shërbimeve në territor.

Zbatimi i këtij objektivi ka sjellë ndikime të prekshme në nivel lokal:

- **Rritje e efikasitetit dhe profesionalizmit institucional** në trajtimin e dhunës në familje, falë trajnimeve dhe bashkëpunimit ndërsektorial.
- **Mbështetje e drejtpërdrejtë për viktimat**, përmes shërbimeve të strehimit emergjent dhe afatgjatë, si dhe kujdesit falas për fëmijët.
- **Funksionalizim i mekanizmave lokalë të referimit dhe ndjekjes**, përfshirë përmirësimin e dokumentimit dhe ndarjen e informacionit.
- **Përfshirje më e mirë dhe me ndjeshmëri gjinore e sociale** në institucionet e kujdesit parashkollor, përmes trajnimit të edukatoreve dhe politikave të mbrojtjes së fëmijëve.
- **Konsolidim i sistemit të shërbimeve sociale** përmes ngritjes së strukturës së monitorimit dhe rritjes së transparencës.

Përqindja e buxhetit bashkiak të dedikuar për shërbime të specializuara për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje dhe me bazë gjinore arriti në 0.9% në vitin 2024, duke shënuar progres drejt objektivit 2%, por duke treguar ende nevojë për priorizim më të madh buxhetor.

Praktikat e mira përfshijnë bashkëpunimin aktiv të bashkisë me shoqërinë civile në fushatat ndërgjegjësuese, përdorimin e platformave në shkollë për edukimin mbi barazinë gjinore si dhe përpjekjet për të integruar çështjet gjinore në planifikimin dhe buxhetimin vendor.

shënuar progres drejt objektivit 2%, por duke treguar ende nevojë për priorizim më të madh buxhetor.

Praktikat e mira përfshijnë bashkëpunimin aktiv të bashkisë me shoqërinë civile në fushatat ndërgjegjëse, përdorimin e platformave në shkollë për edukimin mbi barazinë gjinore si dhe përpjekjet për të integruar çështjet gjinore në planifikimin dhe buxhetimin vendor.

Pavarësisht aritjeve, bashkia në këto vite ka ndeshur edhe vështirësi dhe sfida dhe ka edhe aktivitete të pa realizuara tërësisht ose pjesërisht. Këto janë evidentuar të detajuara në raportin përkatës të monitorimit të zbatimit të PVVBGJ 2022 – 2024 .

Bazuar në sa më sipër Bashkia ka në vijim si prioritet:

- Hartimin, miratimin dhe zbatimin e PVVBGJ 2025 – 2030, bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet nga raporti i monitorimit;
- Institucionalizimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në të gjitha programet buxhetore dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në iniciativat për barazinë gjinore;
- Forcimin e mëtejshëm të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje dhe përmirësimin e sistemeve të të dhënave dhe transparencës.
- Përmirësimin e kapaciteteve të stafit për adresimin në mënyrë më efektive të çështjeve të barazisë gjinore në të gjitha fushat e ndërhyrjes së bashkisë, si dhe vënienë në dispozicion të burimeve të shtuara financiare, për të siguruar që barazia gjinore të integrohet në mënyrë sistematike në të gjitha politikat dhe shërbimet e bashkisë.

Në përfundim, për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak Elbasan:

Miratimin e Raportit të Monitorimit të Planit Vendor të Veprimt për Barazinë Gjinore 2022-2024 të Bashkisë Elbasan, sipas dokumentit bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!


KRYETARI
Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 3678 Prot.

Elbasan, më: 21.07.2025.

RELACION

“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Qamil Lopari”, ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124””, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”””.

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, i relaton Këshillit Bashkiak si në vijim:

- Projekti me interes publik “Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Qamil Lopari”, ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124””, prek pasuritë “pronë private”, paraqitur në planvendosjen bashkëlidhur.
- Burimi i financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025.

Për sa më sipër i relatohet Këshillit Bashkiak të miratojë në parim fillimin e procedurës së shpronësimi për projektin me interes publik “Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Qamil Lopari”, ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124””, si dhe mbulimin financiar të këtij shpronësimi.

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



KRYETARI
Gledian Llatja

Konceptoi: A. Braneshi
Drejtoria P.P.S:
Drejtoria F.B.:
Drejtoria P.U: E. Mihal
Drejtoria D.P.P.D.U:
Drejtoria P.Sh.M:

A. Pisha
A. Suli
A. Merkja
M. Avllazagaj
K. Haxhihyseni
S. Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan, më: ____ .07.2025.

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ .07.2025.

“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Qamil Lopari”, ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124””, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”””.

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .07.2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e procedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi i projektit me interes publik “Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Qamil Lopari”, ndodhur në Z.K 8523 dhe Z.K 2124””. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Sokol Sinani

KRYETARI
Lutfi Lala

Konceptoi: A. Braneshi
Drejtoria P.P.S:
Drejtoria F.B.:
Drejtoria P.U: E. Mihali
Drejtoria D.P.P.D.U:
Drejtoria P.Sh.M:
Drejtoria J. I:
Zv/Kryetar:

A. Pisha
A. Suli
A. Merkja
M. Avllazagaj
K. Haxhihyseni
S. Mehmeti
A. Hoxha
K. Krasnika